

URDHËR
Nr.173, datë 14.3.2020

**PËR NDALIMIN E TË GJITHA LËVIZJEVE TË MJETEVE TË TRANSPORTIT NË
PIKAT KUFITARE TOKËSORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 3, gërma “a” të ligjit nr.15/2016,“ Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, vendimin e Komitetit të Përkohshëm për infeksionin e përhapur nga Coronavirus i ri, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e lëvizjeve me mjetet e transportit për udhëtarët (autobuza, autovetura etj.), në hyrje dhe në dalje në pikat e kalimit kufitar tokësor duke filluar nga ora 23:59 e datës 15.3.2020. Ky kufizim do të qëndrojë në fuqi deri në një urdhër të dytë të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

2. Përjashtim nga rregulli i caktuar në pikën 1 bëjnë mjetet e transportit për mallrat, produkte ushqimore, barna dhe pajisje mjekësore dhe produkte të tjera të nevojshme për shërbimin shëndetësor.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të bashkëpunojë me autoritetet përgjegjëse për kufirin dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**